

**Halliburton B.V-**  
**Dege e nje kompanie te huaj**

**Standartet Kombetare te Kontabilitetit**  
**Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me**  
**31 Dhjetor 2015**

## Permbatja

PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE .....	3
PASQYRA E TE ARDHURAVE PERMBLEDHESE .....	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL .....	6
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE .....	7
SHENIMI 1 – INFORMACION I PERGJITHSHEM.....	8
SHENIMI 2 – BAZA E PREGATITJES .....	8
SHENIMI 3 – BIZNESI NE VIJIMESI.....	9
SHENIMI 4 – PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL .....	9
SHENIMI 5 – PERCAKTIMI I VLERES SE DREJTE .....	13
SHENIMI 6 – MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR .....	14
SHENIMI 7 – MJETE MONETARE.....	15
SHENIMI 8 – KLIENTE PER MALLRA DHE SHERBIME .....	15
SHENIMI 9 – TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE.....	15
SHENIMI 10 – DETYRIME TATIMORE AFATSHKURTRA.....	15
SHENIMI 11 – TE ARDHURA NGA SHITJET .....	15
SHENIMI 12 – SHPENZIME OPERACIONALE.....	15
SHENIMI 13 – TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE.....	16
SHENIMI 14 – TATIMI MBI FITIMIN.....	16
SHENIMI 15 – INSTRUMENTAT FINANCIARE .....	16
SHENIMI 16 – DETYRIME TE KUSHTEZUARA .....	17
SHENIMI 17 – NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT .....	17

Halliburton B.V– Dege e Shoqerise se Huaj  
Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe

PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE

Me 31 Dhjetor 2015

	Shenime	2015	2014
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	7	3,487	-
Investime		-	-
<b>Aktive te tjera afatshkurter</b>			
Kliente per mallra, produkte e sherbime	8	5,857	3,419
<b>Inventari</b>			
Materiale te para		-	-
Prodhimi ne proces		-	-
Produkte te gatshme		984	-
Inventar ne tranzit paisje shpimi per puse naftë		-	4,439
Parapagime per furnitoret		-	-
		<u>984</u>	<u>4,439</u>
<b>Aktive afatshkurtra</b>		<u>10,328</u>	<u>7,859</u>
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale		-	-
Te drejta dhe detyrime nga kompania Meme	4.m.	89,239	-
Aktive afatgjata jomateriale		-	-
Aktive biologjike		-	-
Aktive talimore te shtyra		-	-
<b>Totali aktiveve afatgjata</b>		<u>89,239</u>	<u>-</u>
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<u>99,567</u>	<u>7,859</u>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
<b>Huamarrje afatshkurtra</b>			
<b>Detyrime tregtare dhe te tjera</b>			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	9	13,998	28,607
Detyrime ndaj personelit		-	703
Detyrime talimore afatshkurtra	10	2,466	19
Shpenzime te llogaritura		93	-
<b>Provisionet afatshkurtra</b>		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<u>16,557</u>	<u>29,329</u>

**Halliburton B.V– Dega e Shoqerise se Huaj**  
 Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe

**Detyrimet afatgjata**

Hua dhe letra me vlere afatgjata	-	-
Huamarrje afatgjata brenda grupit	4.b. 127,563	-
Provizionet afatgjata	-	-
Pasive talimore te shlyra	-	-
<b>Totali detyrimeve afatgjata</b>	<b>127,563</b>	<b>-</b>

<b>Totali detyrimeve</b>	<b>144,120</b>	<b>29,329</b>
--------------------------	----------------	---------------

**Kapitali dhe rezervat**

Aksionet e pakices	-	-
Kapitali i aksionereve te shoqerise meme	-	-
Kapitali aksionar i nenshkruar	-	-
Primi i aksioneve	-	-
Rezerva rivleresimi	-	-
Rezerva te tjera	-	-
Te drejta te kompanise meme	-	2,069
Humbje te akumuluar	(23,539)	(2,076)
Fitim / (Humbja) e vitit financiar	(21,014)	(21,463)
<b>Total kapital</b>	<b>(44,553)</b>	<b>(21,470)</b>

<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>	<b>99,567</b>	<b>7,859</b>
--	---------------	--------------

Pasqyrat Financiare jane miratuar nga drejtimi i Halliburton B.V. - Dega e Shoqerise se Huaj dhe jane nenshkruar nga:

Pergatitur nga:

*Anisa Jasini*  
 Ernst & Young Albania SHPK



Halliburton B.V. - Dega e Shoqerise se Huaj

Evasio D'Ancona



**PASQYRA E TE ARDHURAVE PERMBLEDHESE**

Per vitin financiar deri me 31 Dhjetor 2015

	<b>Shenime</b>	<b>2015</b>	<b>2014</b>
<i>Shitjet neto</i>	11	5,084	93,835
<i>Te ardhura te tjera</i>		-	-
<i>Kosto te shitjeve</i>		(3,455)	-
<i>Puna e kryer per qellime te veta dhe e kapitalizuar</i>		-	-
<i>Mallrat, lende te para dhe sherbimet</i>		-	-
<i>Shpenzime operacionale</i>	12	<u>(19,750)</u>	<u>(117,217)</u>
		<u>(18,121)</u>	<u>(23,382)</u>
<i>Shpenzime personeli</i>		(119)	(784)
<i>Pagat</i>		-	(672)
<i>Shpenzimet e sigurimeve shoqerore</i>		(119)	(112)
<i>Shpenzimet per pensionet</i>		-	-
<i>Renia ne vlere dhe amortizimi</i>		-	-
<b><i>Fitimi/humbja nga veprimtarite e shfrytezimit</i></b>		<u><b>(18,240)</b></u>	<u><b>(24,166)</b></u>
<i>Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga shoqerite e kontrolluara</i>		-	-
<i>Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet</i>		-	-
<i>Te ardhura dhe shpenzime financiare</i>		-	-
<i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga investimet afatgjata</i>		-	-
<i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>		-	-
<i>Fitimet (humbjet) nga kursi kembimit</i>	13	2,774	2,703
<i>Te ardhurat dhe shpenzimet te tjera financiare</i>		-	-
<b><i>Totali i te ardhurave dhe shpenzime financiare</i></b>		<u><b>(2,774)</b></u>	<u><b>2,703</b></u>
<b><i>Fitim (humbje) para tatimit</i></b>		<u><b>(21,014)</b></u>	<u><b>(21,463)</b></u>
<i>Shpenzime te tatimit mbi fitimin</i>	14	-	-
<b><i>Humbja neto e vitit financiar</i></b>		<u><b>(21,014)</b></u>	<u><b>(21,463)</b></u>

Halliburton B.V– Dege e Shoqerise se Huaj  
 Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**

**Per vitin financiar deri me 31 Dhjetor 2015**

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksionet e thesarit	Llogaria e Kompanise Meme	Rezerva statutore dhe ligjore	Humbjet e akumuluar	Totali
<b>Pozicioni me 01 Janar 2014</b>	-	-	-	-	-	(2,076)	(2,076)
Fitimi/Humbja neto e vitit	-	-	-	-	-	(21,463)	(21,463)
Dividendet e paguar	-	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-	-	-
Fonde nga kompania meme	-	-	-	2,069	-	-	2,069
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni me 31 Dhjetor 2014</b>	-	-	-	2,069	-	(23,539)	(21,470)
Fitimi/Humbja neto	-	-	-	-	-	(21,014)	(21,014)
Dividendet e paguar	-	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-	-	-
Fonde nga kompania meme	-	-	-	(2,069)	-	-	(2,069)
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni me 31 Dhjetor 2015</b>	-	-	-	-	-	(44,553)	(44,553)

**PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE**

Per vitin financiar deri me 31 Dhjetor 2015

	2015	2014
<b>Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit</b>		
Fitimi para tatimit	(21,014)	(21,463)
Rregullime per:		
Amortizimin	-	-
Zhvleresime te aktiveve	-	-
Diferenca nga kembimet valutore te perealizuara	-	-
Te ardhura nga investimet	-	-
Shpenzime per interesat	-	-
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme	(2,438)	(3,419)
Rritje/renie ne tepricen e inventarit	3,455	(4,439)
Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve per t'u paguar	<u>(12,772)</u>	<u>27,253</u>
Parate e perfituara nga aktivitetet		
Interes i paguar	-	-
Tatim fitimi i paguar	-	-
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit	<u>(32,769)</u>	<u>(2,069)</u>
<b>Fluksi i parave nga veprimtarite investuese</b>		
Blerja e shoqerise se kontrolluar minus parate e arketuara	-	-
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Te ardhura nga shilja e paisjeve	-	-
Interes i arketuar	-	-
Dividende te arketuar	-	-
Paraja neto e perdorur ne aktivitetet investuese	<u>-</u>	<u>-</u>
<b>Fluksi i parave nga veprimtarite financiare</b>		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar	-	-
Te ardhura nga kompania meme	(91,308)	2,069
Te ardhura nga huamarrje afatgjata	127,563	-
Pagesat e detyrimeve te qirase financiare	-	-
Dividende te paguar	-	-
Paraja neto e perdorur ne aktivitetet financiare	<u>36,256</u>	<u>2,069</u>
<b>Rritja/renia neto e mjeteve monetare</b>	3,487	-
Mjete monetare ne fillim te perludhes kontabel	-	-
Diferenca nga kembimet valutore te perealizuara	-	-
Mjete monetare ne fund te perludhes kontabel	<u>3,487</u>	<u>-</u>

Pasqyra e fluksit te parase duhet te lexohet bashke me notat qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare te cilat jane paraqitur nga faqja 8 deri tek 17.

# Halliburton B.V– Dege e Shoqerise se Huaj

Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe

## SHENIMI 1 – INFORMACION I PERGJITHSHEM

Halliburton B.V. Dega ne Shqiperi (referuar me poshte si Dega), e krijuar me date 24 Shtator 2013, ka si objekt aktiviteti te saj ofrimin e sherbimeve, shperndarjen e mallrave ne industrine e kerkimit te naftes dhe te gazit, si dhe importin dhe eksportin e lendeve plasese per perdorim civil ne Republiken e Shqiperise. Dega ka seline e saj ligjore tek Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower Business Center, Kati 10, zyra 103, Tiranë. Për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2015 është përgatitur dhe paraqitur paketa e plotë e pasqyrave financiare, të cilat japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë gjatë kësaj periudhe. Përgatitja dhe paraqitja e tyre, e cila është përgjegjësi e drejtimit të njësisë, është realizuar mbështetur në Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK). Gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Monedha e përdorur është monedha Lek. Ngjarjet dhe transaksionet janë evidentuar gjatë gjithë periudhës ushtrimore në përputhje me: SKK Nr. 1 "Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare" dhe SKK Nr. 2 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" si dhe cdo standard tjetër ndërkombëtar në përputhje me natyrën e ngjarjeve apo transaksioneve të cilat në mënyrë të hollësishme do të jepen në vijim të informacioneve shpjeguese.

## SHENIMI 2 – BAZA E PREGATITJES

### (a) Deklarata e perputhshmerise

Pasqyrat financiare të Deges janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ne Shqiperi (SKK). Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi parimin e kostos historike. Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve të ardhurave dhe shpenzimeve. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykimet kritike për zbatimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm mbi shumat e regjistruara në pasqyrat financiare jepet në shënimet e meposhtme.

### (b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në monedhën kombëtare të Republikës së Shqipërisë Lekë (LEK), e cila është monedha funksionale e Deges. Ndonesa pritet që disa vlerësime kontabel mund të rezultojnë si të pasakta drejtuesit e njësisë ekonomike

### (d) Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SKK kerkon qe drejtimi te kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave dhe shumave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vlerësimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhshme nese ato ndikohen.

Ndonëse pritet që disa vlerësime kontabël mund të rezultojnë si të pasakta, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet të bëjnë vlerësimet më të mira të mundshme, në bazë të njohurive që ata kanë. Kur shfaqen fakte të reja, vlerësimet e bëra më parë duhet të ndryshohen.

### Ndryshimet në vlerësimet kontabël

Një ndryshim në vlerësimin kontabël është Një rregullim i vlerës kontabël neto të Një aktivi ose detyrimi, ose shumës së konsumit periodik të Një aktivi, që rezulton nga vlerësimi i gjendjes aktuale dhe përfitimeve të pritshme të ardhshme dhe detyrimeve lidhur me aktivin dhe detyrimin.



## Halliburton B.V– Dege e Shoqerise se Huaj

Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe

Ndryshimet në vlerësimet kontabël rezultojnë prej informacionit të ri apo zhvillimeve të reja dhe, rrjedhimisht, nuk janë korrigjime të gabimeve. Kur ndryshimi në Një politikë kontabël është i vështirë të dallohet nga Një ndryshim në vlerësimin kontabël, ndryshimi trajtohet si Një ndryshim në vlerësimin kontabël. Ndryshimet në vlerësimet kontabël do të njihen gjatë periudhës kontabël Kur ato kanë ndodhur, dhe jo në retrospektivë. në rrethana të caktuara mund të jetë e vështirë të dallohet nëse ndryshimi ka ndodhur në politikën kontabël apo në vlerësimin kontabël. Në raste të tilla, presupozohet që kemi të bëjmë me Një ndryshim në vlerësimin kontrabël, dhe efekti i ndryshimit njihet gjatë periudhës kontabël, Kur bëhet raportimi (ose në perspektivë), por jo në retrospektivë.

Ndryshimet nga ana e menaxhimit te deges ne vleresimet kontable per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 jane paraqitur si meposhte:

- Njohje e koston se TVSH nga autofaturimi per sherbime te marra ne 2014 nga kompani jo-rezidente ne shumen 2,954,248 Lek, pasi nuk u plotesuan ne kohe procedurat e perjashtimit nga TVSH.

- Ulje e shpenzimeve per pagat ne periudhat e meparshme ne lidhje me administratoret e deges ne shumen 702,827 Lek pasi dega nuk do ti kete shpenzime pagash per administratoret dhe pagat do te jene vetem per efekt te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore.

### SHENIMI 3 – BIZNESI NE VIJIMESI

Pasqyrat financiare të Deges te mbyllura per vitin 2015 jane pergatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Dega do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit te saj edhe për një të ardhme të parashikuar.

### SHENIMI 4 – PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

#### (a) Aktivët afatgjata materiale

##### (i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejte me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve direkte, cdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejte me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qelimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes si ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivit kur perfundon ndertimi i tij, nga ku aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise. Ne rastet kur pjese te aktivit afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem te aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne vleren e mbetur.

##### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet me vleren e mbartur te elementit (vleren kontabel) nese eshte e mundshme qe perfilime ekonomike ne te ardhmen qe i atribuohen atij elementi do te rrjedhin ne dege dhe kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi regjistrohesh mbi baze te vleres se mbetur. Amortizimi njihet duke filluar nga muaji pasardhes i blerjeve. Jetet e dobishme te vleresuara dhe te zbatuara per aktivet jane si me poshte:

Mobilje dhe pajisje zyre	20 %
Pajisje informatike	25 %

Vlera e mbetur e aktiveve dhe jeta e dobishme e tyre rishikohen dhe rregullohen nese eshte e nevojshme ne çdo date bilanci. Nje humbje nga renia ne vlerë e nje aktiviteti njihet nese vlera kontabel eshte me e

## Halliburton B.V– Dege e Shoqerise se Huaj

*Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe*

madhe sesa shuma e rikuperueshme e tij. Humbjet nga renia ne vlere njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Fitimet dhe humbjet nga shitja ose nxjerrja jashte perdorimit e nje aktivi njihen ne shume neto ne zerin 'te ardhura te tjera' ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

### **(b) Instrumentet financiare**

Dega i klasifikon instrumentat financiarë në kategoritë e mëposhtme: Instrumenta të tregtueshme të matura me vlerën e drejtë përmes fitimeve dhe humbjeve, huatë dhe kërkesa të arkëtueshme, investime të mbajtura deri në maturim dhe aktive financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë blerë investimet. Drejtimi i degës përcakton klasifikimin e investimeve të tij në njohjen fillestare dhe rivlerëson këto investime në çdo datë raportimi

#### **- Aktive financiare të matura me vlerën e drejtë përmes fitimeve dhe humbjeve**

Aktive financiare të matura me vlerën e drejtë përmes fitimeve dhe humbjeve janë aktive financiare të tregtueshme. Një aktiv financiar klasifikohet në këtë kategori nëse blihet kryesisht për qëllimin e shitjes në periudhën afatshkurtër. Aktivet në këtë kategori klasifikohen si aktive afatshkurtra, që do të thotë shiten brenda një periudhe 12 mujore për qëllim të këtyre pasqyrave financiare. Gjatë vitit, Dega nuk ka mbajtur ndonjë investim në këtë kategori.

#### **- Huatë dhe kërkesa të arkëtueshme**

Huatë dhe kërkesat e arkëtueshme janë aktive financiare joderivativë me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk kuotohen në një treg aktiv. Ato përfshihen në aktive afatshkurtra, përveç atyre që kanë një afat maturimi më të madh se 12 muaj pas datës së bilancit. Ato klasifikohen si aktive afatgjata. Huatë dhe kërkesat e arkëtueshme të degës përbëhen nga 'Kliente dhe të tjera kërkesa të arkëtueshme' dhe 'mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare' në bilanc. Dega mban vetem instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, kredi dhe hua dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiare jo-derivative përkrahë me poshte.

In-House Cash (IHC) lejon menaxhimin qendror të pagesave dhe arkëtimit midis kompanive të grupit, dhe lehtëson pagesat për partnerët e jashtëm të biznesit në emër të filialeve, përpunon pagesat hyrëse nga partnerët e jashtëm të biznesit, dhe dërgon pagesat për degët ose filialet sipas rastit. Procesi kryesor i In-House Cash (IHC) është për të menaxhuar flukset monetare midis kompanive të grupit të cilat regjistrohen, kompensohen, dhe regjistrohen në llogarinë e In-House Cash. IHC mundeson departamentin e thesarit të Halliburton për të ofruar për degët e saj të njëjtat shërbime ashtu si një bankë e jashtme, duke qenë në thelb një bankë brenda grupit. Përsa i përket fondeve për Shqipërinë, përgjegjëse është Halliburton Worldwide GmbH e cila ka dhënë fonde kur ka qenë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e degës lokale. Për vitin financiar përfunduar më 31 dhjetor 2015, Dega e ka marrë fonde nga Halliburton Worldwide GmbH në vlerë prej 127,563,347 lekë. Financimi nuk është i siguruar pasi është pjesë e marrëveshjes së grupit. Interesi mujor ngarkohet në baza mujore dhe vendoset nga Halliburton Worldwide GmbH. Normat mujore të interesit jepen çdo muaj nga departamenti i thesarit të Halliburton në Houston dhe ata janë të përcaktuara në bazë të marrëveshjes për kompensimin e pagesave midis grupit. Llogaritja e interesit është  $ADB * (norma e interesit / 100) * (numrin e ditëve në muaj / 360)$ .

#### **- Investime të mbajtura deri në maturim**

Investime të mbajtura deri në maturim janë investime me afat maturimi të përcaktuar dhe drejtimi i degës ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë të mbajë deri në maturim. Këto letra me vlerë klasifikohen si aktive afatgjata, përveç letrave me vlerë që arrijnë afatin e maturimit brenda 12 muajve të ardhshëm nga data e bilancit dhe që njihen si afatshkurtra gjatë periudhës raportuese. Gjatë vitit Dega nuk ka mbajtur ndonjë investim në këtë kategori.

#### **- Aktivet financiare të vlefshme për shitje**

Aktivitetet financiare të vlefshme për shitje janë investime jo-derivativë që blihen me qëllim që të mbahen për një periudhë kohe të pacaktuar dhe që mund të shiten kur Shoqëria ka nevojë për burime financiare ose me ndryshimin e normave të interesit. Ato përfshihen në aktive afatgjata vetëm nëse drejtimi synon të shesë brenda 12 muajve nga data e bilancit ose të mund të përdorë ato si burim i kapitalit punues. Në këtë

## Halliburton B.V– Dege e Shoqërise se Huaj

*Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe*

---

rast këto investime klasifikohen si aktive afatshkurtra. Gjatë vitit Shoqëria nuk ka mbajtur ndonjë investim në këtë kategori.

Nje instrument financiar njihet ne rast se Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat kontraktuale te deges ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktivi financiar mbarojne, ose nese dega i transferon aktivin financiar nje pale tjeter, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te nje aktivi financiar jane regjistruar ne daten e tregtimit, p.sh. daten ne te cilen Shoqëria zotohet te bleje ose te shese aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e deges te detajuara ne kontrate mbarojne, jane shlyer ose jane anuluar.

### - Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to perfshijne vlerat ne arke, llogari rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra me maturitet original tre muaj ose me pak, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlerë dhe perdoren nga dega ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen me koston e amortizuar.

### - Kërkesa per arketim

Kërkesat per arketim njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuar per humbjet per zhvleresime.

### - Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar.

### - Te tjera

Instrumenta financiare te tjere jo-derivative maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

## (c) Zhvleresimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi. Nëse egziston një evidencë e tillë, aktivi financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për rënie vlerë. Një humbje nga rënia në vlerë në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivet financiare të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje me rreziqet kredituese. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga rënia në vlerë rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me njëngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## (d) Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Deges përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë aktiv rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse një tregues i tillë ekziston atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus koston e shitjes. Për qëllim të testimit të zhvlerësimit, aktivet grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse monetare hyrëse nga përdorimi i vazhdueshëm që janë kryesisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të aktiveve ("Njësia gjeneruese e mjeteve monetare").

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me njësitë gjeneruese të mjeteve monetare janë ndarë për të zvogëluar vlerën kontabël neto të aseteve në njësi (grup njësish) në mënyrë proporcionale. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar

## Halliburton B.V– Dege e Shoqerise se Huaj

Shumat ne ('000) Lek, *pervecse aty ku percaktohet ndryshe*

---

nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Humbja nga rënia në vlerë rimerret nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në masën në të cilën vlera kontabël e aktivitetit nuk e kalon vlerën e aktivitetit që duhet të përcaktohet neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

### (e) Inventaret

Inventarët vlerësohen në bilanc me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet sipas metodës së kostos mesatare të ponderuar dhe përfshin të gjitha shpenzimet që ndodhin në blerje dhe gjatë transferimit të tyre në vendodhjen dhe konditat ekzistuese. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur shpenzimet e vlerësuara të përfundimit dhe të shitjes. Me 31 Dhjetor 2015 Dega ka inventar në llogarite e saj në shumën 984,205 Lek.

### (f) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat përfshijnë vlerën e drejte të shumës së marre ose që është për t'u marre nga shitja e shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të degës. Të ardhurat nga shitja e shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumave të arkëtuara ose të pritshme për tu arkëtuar, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, anulimet, ujlet dhe skontot. Te ardhurat njihen kur shërbimi është kryer, shumën e te ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme dhe kostot që kanë ndodhur ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme.

### (g) Perfitimet e Punonjesve

#### Sigurimet shoqerore të detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqerore të detyrueshme që përcaktojnë perfitimet e punonjesve që dalin në pension. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e degës ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin

#### Leje Vjetore të Paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbe për shërbimin e punonjesve gjatë periudhës.

#### Perfitimet nga nderprerja e marrëdhënieve të punës

Perfitimet nga nderprerja e marrëdhënieve të punës janë të pagueshme kur marrëdhënia e punës ndërpritet nga dega përpara datës normale të daljes në pension, ose atëherë kur një punonjes pranon largimin vullnetar nga puna në shkëmbin të këtyre perfitimeve. Dega njih perfitimet nga nderprerja e marrëdhënieve të punës kur demonstroi se është e angazhuar për të ndërprerë marrëdhëniet e punës të punonjesve aktual sipas një plani zyrtar të hollësishëm dhe nuk ka mundësi realiste të heqëje, ose për të nxitur largimin vullnetar nga puna. Perfitimet nga nderprerja e marrëdhënieve të punës të pagueshme pas më shumë se 12 muajve pas datës së raportimit skontojnë në vlerën aktuale.

### (h) Shpenzimet

#### Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

#### Shpenzimet e qirase

Shpenzimet e qirase të zakonshme janë ngarkuar në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë periudhës së qirase. Pagesat si motivim të marra nga qiradhenesi janë njohur si pjesë perberëse e shpenzimit total të qirase përgjatë periudhës së qirase.

### (i) Te ardhura dhe shpenzime financiare

## Halliburton B.V – Dege e Shoqerise se Huaj

Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite me banka dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen kur matorohen duke perdorur metoden e interesit efektiv. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kursi i kembimit raportohen mbi baza neto.

### (j) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin aktual i cili njihet ne Pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve. Tatimi aktual eshte tatimi i pritshem i pagueshem mbi te ardhurat e tatueshme per periudhen, duke perdorur normat e tatimore te aplikuara ne daten e pergatitjes se pasqyrave financiare. Per vitin financiar te mbyllur me 31 Dhjetor 2015 norma e tatim fitimit eshte 15%. Duke qene se Dega vazhdon te jete me humbje dhe ne vitin 2015 ne shumen (21,014,890) Lek dhe nga viti 2014 ne shumen (21,462,877) Lek ajo nuk eshte subjekt i tatim fitimit. Dega ka te drejte te mbarti humbjen e akumuluar per tre vite.

### (k) Provizionet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar. Shoqeria ka nje detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkohen flukse dalese mjeteshe monetare per shlyerjen e ketij detyrimi. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te mjeteve monetare me nje norme para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet specifike te detyrimit. Gjate vitit 2015 nuk eshte njohur asnje provizion nga menaxhimi i deges.

### (l) Transaksionet ne monedhat te huaja

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i kembimit per zerat monetare eshte diferenca ndermjet kostove te amortizuara ne monedhen funksionale ne fillim te periudhes, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjate periudhes, dhe kostove te amortizuara ne monedhe te huaj te konvertuara me kursin e kembimit ne fund te periudhes. Aktivet dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj qe maten me vlere te drejte konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten kur eshte vendosur vlera e drejte. Diferencat nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi njihen ne fitim ose humbje, pervec diferencave nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi i huave nga aksioneret te cilet njihen ne te ardhurat permbledhese.

### (m) Palet e lidhura

Palet jane te lidhura me Degen ne menyre direkte ose indirekte permes nje ose me shume ndermjetesve, ato drejtojne, drejtohen ose jane ne drejtim te perbashket me te. Palet kane interes tek Dega, gje qe i jep nje ndikim te konsiderueshem mbi te. Palet mund te jene pjese e personelit, menaxhimit ose Mema e Deges. Kompania Meme dhe Dega kane te njejtin status juridik. Mema mbulon te gjitha shpenzimet operacionale te Deges dhe gjithashtu eshte perfituesi i drejte per drejt i fitimeve te gjeneruara nga Dega. Gjate vitit 2015 Mema ka mbuluar shpenzime operacionale per degen ne shumen 12,070,796 Lek ndersa Dega ka te drejte te arketueshme kundrjet memes per te ardhurat e gjeneruara nga Dega ne 2014 qe jane paguar direkt ne llogari te memes ne shumen 101,309,433 Lek. Me poshte eshte paraqitur marredhenia e Deges me Memen me 31 dhjetor 2015:

Kompanise Meme:

31 Dhjetor 2015  
89,238,637

Shpenzimet operacionale te kryera gjate vitit 2015 nga kompani te grupit jane paraqitur ne shenimin 13.

### SHENIMI 5 – PERCAKTIMI I VLERES SE DREJTE

Vlera e drejte e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to, llogarive te arketueshme dhe te pagueshme eshte perafersisht e barabarte me vleren kontabel per shkak te maturitetit te tyre te shkurter.

## SHENIMI 6 – MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Manaxhimi i rrezikut është një element i rëndësishëm i operacioneve të Deges. Rreziqet kryesore me të cilat përballet Dega janë ato që lidhen me rrezikun e tregut, i cili përfshin rrezikun e çmimit, të normës së interesit dhe të kursit të këmbimit rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Dega është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shenim paraqet informacionin rreth ekspozimit të deges ndaj secilit prej rreziqeve të mesiperm, objektivat, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shenime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në keto pasqyra financiare. Administratori mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e deges për menaxhimin e rrezikut.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball dega, për të vendosur limitet dhe kontrollet e pershtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e deges. Dega, përmes trajnimeve, standardeve dhe procedurave të menaxhimit synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Drejtimi i Deges në bashkëpunim të ngushtë me dhe mbikëqyrjen nga strukturat e menaxhimit të riskut ka përgjegjësi të plote për mbikëqyrjen e kuadrin të menaxhimit të riskut, mbikëqyrjen e menaxhimit të rreziqeve kryesore dhe rishikimin e politikave dhe procedurave të tij të menaxhimit të rrezikut sikurse miratimin e transaksioneve të rëndësishme dhe me shumica të konsiderueshme. Si faktorët e rrezikut të brendshëm ashtu edhe ato të rrezikut të jashtëm janë identifikuar dhe menaxhuar përgjate gjithë strukturës organizative të Deges dhe veçanërisht nga strukturat e menaxhimit të riskut në nivel grupi. Instrumentet financiare kryesore të deges konsistojnë në vlerat në banka, llogaritë e arketueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

### (i) Rreziku i kredisë

Rreziku i mospageses ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arketueshme. Maksimumi i rrezikut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arketueshme minus detyrimet kundrejt të njejtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Rreziku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nepermjet zhvlerësimeve. Dega e vlereson cilësinë e llogarive të arketueshme që nuk janë me vonesë dhe as të zhvlerësuar si shumë të kenaqshme.

### (ii) Rreziku i likuiditetit

Dega duhet të përmbushë nevojat për mjete monetare, kryesisht për kostot e shfrytëzimit që rrjedhin nga aktivitetet e saj. Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme. Dega monitoron likuiditetin në baza periodike në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur ato kerkohen.

### (iii) Rreziku i tregut

#### Rreziku i normave të interesit

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 dega ka patur shpenzime interesi në vlerën 825 Lek. Një ndryshim me 10 pike baze në normën e aplikuar të interesit do të kishte një efekt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me afersisht 0.8 Lek.

#### Rreziku i kursit të këmbimit

Dega ndërmerr transaksione në leke, EUR dhe USD. Rreziku i pozicionit valutor menaxhohet nepermjet parimit të përputhjes së aktiveve me detyrimet. Dega nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontrata të ardhshme shkëmbimi me 31 Dhjetor 2015. Me 31 Dhjetor 2015 kursi i këmbimit ishte:

EUR = 137.28      USD = 125.79

**Halliburton B.V– Dege e Shoqerise se Huaj**  
*Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe*

**Analiza e ndjeshmerise**

Me anen e menaxhimit te rrezikut te normave te interesit dhe te pozicionit valutor, dega synon te reduktoj ndikimin e luhatjeve afatshkurtra ne fitim. Ne nje periudhe afatgjate, sidoqofte, ndryshimet e perhershme ne kurset e kembimit dhe normat e interesit mund te kene nje ndikim ne fitim. Nje ndryshim me 10 pike baze ne normen e aplikuar te interesit do te kishte nje efekt ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me afersisht 0.8 Lek.

**SHENIMI 7 – MJETE MONETARE**

	<u>2015</u>	<u>2014</u>
Llogari rrjedhese Raiffeisen Bank Lek	533	-
Llogari rrjedhese Raiffeisen Bank Euro	2,954	-
	<u>3,487</u>	<u>-</u>

**SHENIMI 8 – KLIENTE PER MALLRA DHE SHERBIME**

	<u>2015</u>	<u>2014</u>
Furnizim paisjesh/ qira	4,778	3,419
Shitje materialesh	1,080	-
	<u>5,857</u>	<u>3,419</u>

**SHENIMI 9 – TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE**

	<u>2015</u>	<u>2014</u>
Furnitore	3,452	4,825
Te pagueshme ndaj paleve te lidhura	10,546	23,782
	<u>13,998</u>	<u>28,607</u>

**SHENIMI 10 – DETYRIME TATIMORE AFATSHKURTRA**

	<u>2015</u>	<u>2014</u>
Detyrime per sigurime shoqerore	50	16
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat nga punesimi	-	3
Detyrime te tjera tatimore	2,416	-
	<u>2,466</u>	<u>19</u>

**SHENIMI 11 – TE ARDHURA NGA SHITJET**

	<u>2015</u>	<u>2014</u>
Te ardhura nga shitja	5,084	93,835
	<u>5,084</u>	<u>93,835</u>

**SHENIMI 12 – SHPENZIME OPERACIONALE**

**Shpenzime nga palet e lidhura**

	<u>2015</u>	<u>2014</u>
Shpenzime administrative te zyres rajonale	6,887	8,597
Shpenzime personeli dhe qiraje	-	81,097
Shpenzime honorare	1,669	8,348
Shpenzime assistence per shitjet	422	2,112
Shpenzime te tjera	225	-
	<u>9,203</u>	<u>100,154</u>

**Halliburton B.V– Dege e Shoqerise se Huaj**  
*Shumat ne ('000) Lek, pervecse aty ku percaktohet ndryshe*

<b>Shpenzime te tjera operacionale</b>		
Shpenzime administrative, konsulence fiskale dhe ligjore	10,099	16,950
Shpenzime akomodimi	53	-
Shpenzime te tjera	112	53
Sherbime doganare	17	-
Shpenzime transporti	191	-
Shpenzime per taksat bashkiake	25	25
Penalitetet dhe gjoba	51	35
	<u>10,548</u>	<u>17,063</u>
<b>Shpenzime operacionale total</b>	<u><b>19,750</b></u>	<u><b>117,217</b></u>

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 jane identifikuar faktor te rinj nga kompania dhe eshte njohur kosto e TVSH ne shumen 2,954,248 nga autofaturimi i sherbimeve te marra nga palet e lidhura ne 2014. Ky ndryshim eshte reflektuar ne menyre prospektive ne perputhje me SKK 1.

**SHENIMI 13 – TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE**

	<u>2015</u>	<u>2014</u>
Interest expenses	(825)	-
Exchange rates profit	1,197	8,093
Exchange rates loss	(2,975)	(5,389)
Banking services	(171)	-
	<u>(2,774)</u>	<u>2,703</u>

**SHENIMI 14 – TATIMI MBI FITIMIN**

Duke qene se Dega vazhdon te jete me humbje dhe ne vitin 2015 ne shumen (21,014) Lek dhe nga viti 2014 ne shumen (21,463) Lek ajo nuk eshte subjekt i tatim fitimit. Dega ka te drejte te mbarti humbjen e akumuluar per tre vite. Norma e tatim fitimit per vitin 2015 eshte 15%.

**SHENIMI 15 – INSTRUMENTAT FINANCIARE**

*Ekspozimi ndaj rrezikut te likuiditetit*

<b>31 Dhjetor 2015</b>	<b>Vlera e mbetur</b>	<b>Deri 3 muaj</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-5 vite</b>
<b>Aktivët Financiare</b>				
Mjete Monetare	-	-	-	-
Aktive te tjera financiare afatshkurtra	-	-	5,857	-
<b>Total</b>	-	-	<u>5,857</u>	-
<b>Detyrimet Financiare</b>				
Detyrime ndaj furnitoreve	-	-	13,998	-
Detyrime Tatimore	-	-	2,466	-
Te tjera	-	-	-	-
<b>Total</b>	-	-	<u>16,464</u>	-
<b>Hendeku</b>	-	-	<u>(10,607)</u>	-



**SHENIMI 16 – DETYRIME TE KUSHTEZUARA**

Ceshtjet gjyqësore dhe paditë

Gjatë aktivitetit normal, Dega mund të përfshihet në procedime gjyqësore, padi ose procese gjyqësore me palë të treta. Drejtimi beson se cdo ngjarje e mundshme në të ardhmen nuk do të ketë efekte negative të rëndësishme në pozicionin financiar, rezultatet e aktiviteteve ose flukset monetare të Deges.

**SHENIMI 17 – NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT**

Drejtimi i Deges nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas dates së raportimit e cila mund të kërkojë rregullime ose shenime shpjeguese shtese në pasqyrat financiare.

Dega në Shqipëri e Halliburton B.V.

NIPTI: L32124010K

Adresa: "Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower Business Center, kati 10, zyra 103", Tirane

Shumat ne Leke

(000' Leke)

**Aktivitet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2015**

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2015	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2015
1	Toka		-	-	-	-
2	Ndertime		-	-	-	-
3	Makineri,paisje		-	-	-	-
4	Mjete transporti		-	-	-	-
5	kompjuterike		-	-	-	-
6	pajisje zyre		-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

**Amortizimi A.A. Materiale 2015**

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2015	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2015
1	Toka		-	-	-	-
2	Ndertime		-	-	-	-
3	Makineri,paisje,vegla		-	-	-	-
4	Mjete transporti		-	-	-	-
5	kompjuterike		-	-	-	-
6	pajisje zyre		-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

**Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2015**

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2015	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2015
1	Toka		-	-	-	-
2	Ndertime		-	-	-	-
3	Makineri,paisje,vegla		-	-	-	-
4	Mjete transporti		-	-	-	-
5	kompjuterike		-	-	-	-
6	Pajisje zyre		-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

Dega në Shqipëri e Halliburton B.V.

Evasio D'Ancona



Dega në Shqipëri e Halliburton B.V.

NIPT: L32124010K

Adresa: "Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower Business Center, kat

Pasqyre Nr.3

(000' Leke)

	Aktiviteti	Te ardhurat nga aktiviteti	
1	Tregtë	Tregtë karburanti	-
2	Tregtë	Tregtë ushqimore, pije	-
3	Tregtë	Tregtë materiale ndertimi	-
4	Tregtë	Tregtë cigaresh	-
5	Tregtë	Tregtë artikuj industrial	-
6	Tregtë	Farmacit	-
7	Tregtë	Eksport mallrash	-
8	Tregtë	Tregtë te tjera	-
I		<b>Totali I te ardhurave nga tregtia</b>	-
9	Ndertim	Ndertim banese	-
10	Ndertim	Ndertim pune publike	-
11	Ndertim	Nderime te tjera	-
II		<b>Totali I te ardhurave nga ndertimi</b>	-
12	Prodhim	Eksport, prodhime te ndryshme	-
13	Prodhim	Fason te cdo lloji	-
14	Prodhim	Prodhim materiale ndertimi	-
15	Prodhim	Prodhim ushqimore	-
16	Prodhim	Prodhim pije alkolike, etj	-
17	Prodhim	Prodhime energji	-
18	Prodhim	Prodhim hidrokarbure,	-
19	Prodhim	Prodhime te tjera	-
III		<b>Totali I te ardhurave nga prodhimi</b>	-
20	Transport	Transport mallrash	-
21	Transport	Transport malli nderkombetare	-
22	Transport	Transport udhetaresh	-
23	Transport	Transport udhetaresh nderkombetare	-
IV		<b>Totali I te ardhurave nga transporti</b>	-
24	Sherbimi	Sherbime financiare	-
25	Sherbimi	Siguracione	-
26	Sherbimi	Sherbime mjekesore	-
27	Sherbimi	Bar restorante	-
28	Sherbimi	Hoteleri	-
29	Sherbimi	Lojra Fati	-
30	Sherbimi	Veprimtari televizive	-
31	Sherbimi	Telekomunikacion	-
32	Sherbimi	Eksport sherbimesh te ndryshme	-
33	Sherbimi	Profesione te lira	-
34	Sherbimi	Sherbime te tjera	5.084
V		<b>Totali I te ardhurave nga sherbimet</b>	<b>5.084</b>
		<b>TOALI (I+II+III+IV+V)</b>	<b>5.084</b>

Te punesuar mesatarisht per vitin 2015:	Nr. I te punesuarve
Me page deri ne 22.000 leke	
Me page nga 22.001 deri ne 30.000 leke	2
Me page nga 30.001 deri ne 66.500 leke	
Me page nga 66.501 deri ne 97.030 leke	
Me page me te larte se 97.030 leke	
<b>Totali</b>	<b>2</b>

Dega në Shqipëri e Halliburton B.V.  
Evaslo D'Ancona



**Dega në Shqipëri e Halliburton B.V.**

**NIPT:L32124010K**

**Adresa: "Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower Business Center, kati 10, zyra 103", Tirane**

## DEKLARATE

Deklaroj se Halliburton B.V. - Dega në Shqipëri, e identifikuar me NIPT L32124010K dhe përfaqësues z. Piotr Szczurak dhe z. Evasio D'Ancona zotërohet 100% nga Kompania Meme Halliburton B.V. me adresë në Amperestraat 1G, 1976BE IJmuiden, Hollandë. Halliburton B.V. - Dega në Shqipëri i ka pregatitur Pasqyrat Financiare të vitit 2015 konform Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

**Hartuesi i Pasqyrave Financiare është:**

Kompania "Ernst & Young Albania Shpk", me NIPT L01930009J

**Ne emer të Dega në Shqipëri e Halliburton B.V.**



**Dega në Shqipëri e Halliburton B.V.**  
**NIPT: L32124010K**  
**Adresa: "Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower"**

### DEKLARATE

Deklaroj se Halliburton B.V.- Dega në Shqipëri, e identifikuar me NIPT L32124010K, dhe me përfaqësues z. Piotr Szczurak dhe z. Evasio D'Ancona, deklaror se nuk ka automjete në pronësi. Ndërsa inventari i materialeve të deklaruara në pasqyrat financiare përbehet nga inventar si më poshtë:

Pershkrimi	Sasia	Vlera e inventarit në Lek	Vlera e Artikujve në USD
6 1/8 FXD64 FIX CUTTER BIT	1	984.214Lek	\$ 8.686,80
		984.214Lek	\$ 8.686,80

Ne emer te Dega në Shqipëri e Halliburton B.V.

Evasio D'Ancona

